



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 47 Prot.

Tiranë më 26/1 /2016

**Proces-verbal**

**Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së**

Sot, në datën 26.1.2016 në orën 17:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u mbajt mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Dëgjese e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC lidhur me fondin e vitit 2016.
2. Propozime e mendime lidhur me Thirrjen e radhës si edhe përcaktimin e një periudhe paraprake konsultimim me OJF-të përpara shpalljes së Thirrjes së ardhshme.
3. Propozimi dhe miratimi i një anëtari titullar dhe një anëtari zëvendësues si përfaqësues të AMSHC në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.
4. Të tjera

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe anëtarëve të Bordit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Alban DUDUSHI
3. Z. Aldo MERKOCI
4. Z. Ismail ADEMI
5. Znj. Kozara KATI

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaroi të hapur mbledhjen në orën 17:00.

Menjëherë Kryetari i jep ljalën Drejtorit Ekzekutiv Kananaj i cili, pasi uron mirëscradhjen si edhe një vit të suksesshëm anëtarëve të Bordit Mbikqyrës të AMSHC, vijon me raportimin rreth shifrës së ngelur për fondin e 2016.

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC tha: *“Bazuar në fondin e detajuar i cili është tashmë i kontraktuar kryesisht për mbylljen e projekteve nga Thirrja 7 si edhe nga Thirrja 8, nga të dhënat e tabelës sipas përlllogaritjeve nga specialistët e AMSHC, rezultoi se shumica e mbetur në dispozicion për*

përdorim nga fondet ( 604) të Vitit 2016 është 76,700,000 Lekë." ( Drejtori i referohet tabelës me të dhënat e sipërpërmendura të cilën e gjeni bashkëngjitur këtij procesverballi)

Më tej Drejtori Ekzekutiv i AMSHC u shpreh lidhur me ecurinë e procesit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Ai sqaroi se: "Më datë 28 Dhjetor 2015 Agjencia për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile në zbatim të Ligjit Nr. 119 datë 06.11.2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Ky proces ka ecur nën frymën e bashkëpunimit me aktorët europianë dhe janë ndjekur udhëzimet përkatëse, ashtu siç parashikohet tek materiali i ardhur nga eksperti i jashtëm z. Igor Vidacak, mbi "Udhëzimin teknik në lidhje me procedurën për zgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile". Procesi në fjalë do të hapet me një konsultim publik i cili ishte parashikuar të mbyllet më datë 11.01.2016. Në datën 12 Janar 2016 do të zhvillohet një takim i hapur pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të dhënë rekomandimet e fundit dhe për të vendosur mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve. Por kjo nuk u realizua pasi z. Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, njëkohësisht edhe Kryetar i KKSHC, nuk ka mundur ende të gjejë kohën për t'u konsultuar dhe për t'u sqaruar më tej me kolegët e tjerë lidhur me ecurinë e mëtejshme të procesit në fjalë. Kjo gjë solli edhe anulimin e detyruar të datës së përcaktuar për zhvillimin e procesit të konsultimit publik lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve. Më herët AMSHC, ka dërguar edhe një kërkesë zyrtare në KM me anë të së cilës është kërkuar ndryshimi i strukturës dhe organikës së AMSHC, me qëllim që të mundësohet shtimi i tre punonjës efektivë, kjo veçanërisht e lidhur me zbatimin e ligjit për KKSHC, konkretisht me nevojën e ngritjes së një komisioni përzgjedhës i përbërë nga stafi i AMSHC. Shpreh edhe njëherë shqetësimin lidhur me kërkesën e AMSHC për shtim në organikë e cila mbetet ende pa miratimin e pritshëm. Ndërkohë që organizata të ndryshme të shoqërisë civile kanë dorëzuar pranë AMSHC propozimet e tyre për kandidatë për KKSHC, mbetemi në pritje të zgjidhjes së çështjeve të mësipërme."

Në përfundim të dëgjësës së Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC, mbledhja vazhdoi më tej sipas pikës pasuese të rendit të ditës ku anëtarët e pranishëm në mbledhje hodhën propozime e mendime lidhur me Thirrjen e radhës si edhe përcaktimin e një periudhe paraprake konsultimim me OJF-të përpara shpalljes së Thirrjes së ardhshme.

Z. Aldo Merkoçi u shpreh : " Sugjeroj si shumë të nevojshëm një periudhë një mujore konsultimi me OJF-të lidhur me tematikat, interesin, përbërjen e tyre etj. Sugjeroj gjithashtu që si pjesë e kësaj periudhe konsultimi të shërbejë edhe ndonjë formë e mundshme anketimi, p.sh. një 'Google Survey', dhe e cila do të nxirte në pah të dhëna më konkrete lidhur me pikat që përmenda më sipër. Mendoj se duhet të krijohet më shumë afritet me OJF-të, për të nxjerrë të dhëna më konkrete rreth OJF-ve lidhur me temat e fokusit të tyre, numrin e anëtarët të stafit të tyre, prioritetet e tyre etj. Me anë të anketimit që sugjeroj krijohet një qasje e tipit 'touch down' me këto OJF duke sjellë padiskutim si pasojë edhe rezultate më të mira."

Z. Thano u shpreh : *"Mendoj se kjo procedurë do të sillte rezultate positive duke rritur më tej transparencën por edhe pritshmëritë e vetë OJF-ve të përfshira në këtë proces konsultimi."*

Z. Merkoçi vazhdoi: *"Përveç të tjerash kjo është një procedurë që duhet zbatuar rregullisht duke u dhënë mundësinë e duhur gjithë OJF-ve."*

Z. Ismail Ademi tha: *"Mendoj se është një proces i vlefshëm, por mendoj se duhet të bëhet gjithashtu një menaxhim shumë i mirë i tij me qëllim që të arrihen rezultatet e duhura."*

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC, z. Andi Kananaj u shpreh: *"Jam dakord me mendimet e mësipërme dhe gjithashtu sugjeroj që të realizohen periudha e procesit të konsultimit apo e një trajnimi sqarues me OJF-të ashtu sikurse është vepruar edhe më parë pasi kështu e parashikon edhe vetë ligji."*

Z. Ademi tha : *"Sugjeroj të përcaktojmë periudhën fillestare dhe afatin përfundimtar të procesit të konsultimit të hapur me OJF-të."*

Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC, z. Thano vijoi: *"Sugjeroj që procesit të konsultimit t'i japim një periudhë kohore prej dy javësh. Sugjeroj muajin pasardhës prej datës 1.2.2016 deri në datën 15.2.2016 si periudhë për konsultimin publik me OJF-të dhe në datë 16.2.2016, parashikoj mundësinë e realizimit të mbledhjes së radhës të Bordit Mbikqyrës të AMSHC."*

Gjithë anëtarët e Bordit Mbikqyrës së AMSHC të pranishëm në këtë mbledhje, gjithashtu edhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC dhanë miratimin e tyre për sugjerimet e bëra nga Kryetari i BM dhe u vendos unanimitisht që procesi i konsultimit të zgjasë për një periudhë dy javore duke nisur në datë 1.2.2016 dhe afati përfundimtar të jetë data 15.2.2016, duke vijuar më tej me një Mbledhje Bordi e cila u përcaktua të mbahet pas përfundimit të procesit të konsultimit, në datë 16.2.2016.

Në vijim të shqyrtimit të pikave sipas rendit të ditës u diskutua edhe çështja e përzgjedhjes së një anëtari titullar dhe një anëtari zëvendësues si përfaqësues të AMSHC në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile. Pas disa diskutimesh dhe mendimesh lidhur me çështjen në fjalë u propozua që Z. Adrian Thano në cilësinë e Kryetarit të Bordit Mbikqyrës të AMSHC- së të përfaqësojë këtë Institucion pranë Këshillit ndërsa znj. Kozara KATI- në cilësinë e anëtares së Bordit Mbikqyrës të AMSHC- së u emërua sipas miratimit të përfaqësojë AMSHC- në në cilësinë e zëvendësueses së z. Thano pranë këtij Këshilli në cilësinë e përfaqësimit të Institucionit.

Pas këtij miratimi unanimit konsensual, z. Thano i'u drejtua pjesëmarrësve për ndonjë propozim apo pyetje dhe u konstatua se të pranishmit nuk kishin asnjë të tillë. Mbledhja u deklarua e mbyllur në orën 18:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

---

**Adrian THANO**

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

**Majlinda DHUKA**

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

**Alban DUDUSHI**

Anëtar

**Albana Kociu**

Anëtare

**Aldo MERKOCI**

Anëtar

**Endri FUGA**

Anëtar

**Gelardina PRODANI**

Anëtare

**Ismail ADEMI**

Anëtar

**Kozara KATI**

Anëtare